

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Ecja dhe shikimi, vështirësitë më të shpeshta të shqiptarëve; 28% raportojnë kufizime                                                                                                                                                   |
| ADRESA  | <a href="https://lapsi.al/ecja-dhe-shikimi-veshtiresite-me-te-shpeshta-te-shqiptareve-28-raportojne-kufizime-i1094354">https://lapsi.al/ecja-dhe-shikimi-veshtiresite-me-te-shpeshta-te-shqiptareve-28-raportojne-kufizime-i1094354</a> |
| BURIMI  | lapsi.al                                                                                                                                                                                                                                |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 24 shtator 2026, 05:48:53 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 05:47:55 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | ec877e0e2f159caa858bdf9563515d42708e8ce7c7e307a057f6e4dfdbd9da6  |
| TEKSTI     | ee817395ab794401c7a9169c2d5531d4af234c94529a0bf9218acacaf9e6abab |
| PAMJA      | d42bfa999592329faed712442f13a25eae68299726ec46a0fda670af8d7a1e6a |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | abb80b928f6a6f22f9ae5ac4433eb5421734b3fccccb7163efa3320f411ff23fa                               |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 122482f56b4d3614be19a0dd70b47463845340fd059902263a617f0a6d32bf80                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/abb80b928f6a6f22f9ae5ac4433eb5421734b3fccccb7163efa3320f411ff23fa>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# Ecja dhe shikimi, vështirësitë më të shpeshta të shqiptarëve; 28% raportojnë kufizime



LAPSI.AL • 24 SEPTEMBER 2026



Më shumë se një në katër persona të moshës 16 vjeç e lart në Shqipëri raportojnë vështirësi të moderuara ose të rënda në të paktën një aktivitet bazë të përditshëm.

Ecja dhe shikimi janë dy problemet që raportohen më shpesh, ndërsa Shqipëria ka një nivel më të ulët se mesatarja europiane në total, por për disa vështirësi specifike, si ecja, dëgjimi, komunikimi dhe kujdesi për veten, përqindjet janë më të larta se në BE.

Sipas të dhënave të Eurostat, 28.4% e personave 16 vjeç e lart në Shqipëri raportonin në vitin 2022 vështirësi të moderuara ose të rënda në të paktën një nga gjashtë aktivitetet bazë të matura: shikim, dëgjim, ecje, kujtesë ose përqendrim, komunikim dhe kujdes për veten.

Në të njëjtin vit, mesatarja e Bashkimit Europian ishte 37.4%. Eurostat vëren se më shumë se një në tre evropianë të kësaj grupmoshe raportonte të paktën një vështirësi të tillë.

Shqipëria është e teta nga fundi, që raporton më pak vështirësi. Në Europë, niveli më i ulët i vështirësive raportohet nga Serbia (19.2%), Mali i Zi (20%), Italia (23%).

Problematikat më të mëdh raportohen nga vendet nordike Norvegjia (62.4%), Danimarka (60.1%), Finlanda 54%, teksa ata raportojnë nivele të larta të problematikës me kujtesën dhe përqendrimin.

## Për çfarë “ankohen” më shumë shqiptarët?

Në Shqipëri, ecja është vështirësia më e raportuar, nga 19.4% e personave, e ndjekur pothuajse në të njëjtin nivel nga shikimi, me 19.3%.

Më pas renditen vështirësitë në dëgjim, me 13.2%, problemet me kujtesën ose përqendrimin, me 11.1%, vështirësitë për kujdesin ndaj vetes, me 8.5%, dhe ato në komunikim, me 7.3%.

Modeli është i ngjashëm me atë evropian, por jo plotësisht. Në BE, në vitin 2022

## ide



**Rënia e Vlorës në shtratin e krimit**  
Armand Shkullaku



**Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi**  
Andi Bushati

MOTITIRANA

12°C

KËMBIMIEURO

91.46

## aktuale

07:44

**Ditë e ngarkuar në Kuvend: Protestë jashtë, interpelanca dhe debate brenda**

20:33



Protestuesit kërkojnë "kokën" e Ramës: Krejt ekipi në pranga, s'të shpëton dot as banda



**TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në



## Me interes nga publiku



moderuar dhe ngjashëm me ato europian, por jo plotësisht. Në BE, në vitin 2022, problemi më i përhapur ishte shikimi, me 20.3%, i ndjekur nga ecja me rreth 18%.

Eurostat evidenton se shikimi dhe ecja janë në përgjithësi dy vështirësitë më të zakonshme në Europë, ndërsa komunikimi dhe kujdesi për veten janë më pak të shpeshtat.

Por Shqipëria del mbi mesataren e BE-së në katër nga gjashtë problematikat.

Vështirësitë në ecje raportohen nga 19.4% e shqiptarëve, kundrejt 18.3% në BE; në dëgjim nga 13.2%, kundrejt 11.9%; në kujdesin për veten nga 8.5%, kundrejt 6.6%; ndërsa diferenca më e madhe është te komunikimi, 7.3% në Shqipëri kundrejt 4.7% në BE.

Në të kundërt, vështirësitë në shikim janë pak më të ulëta se mesatarja europiane, 19.3% kundrejt 20.3%, ndërsa diferenca është më e madhe te kujtesa dhe përqendrimi: 11.1% në Shqipëri, kundrejt 15.2% në BE.

Shqipëria e dyta në rajon, pas Maqedonisë së Veriut

Në Ballkanin Perëndimor, për krahasimin e të njëjtit vit, Maqedonia e Veriut kishte përqindjen më të lartë, me 34.8% të popullsisë 16 vjeç e lart që raportonte të paktën një vështirësi të moderuar ose të rëndë.

Shqipëria renditej e dyta me 28.4%, e ndjekur nga Bosnjë-Hercegovina me 24%, Serbia me 21.9% dhe Mali i Zi me 20%.

Maqedonia e Veriut kishte nivelet më të larta në rajon për pothuajse të gjitha kategoritë: 26.6% për shikimin, 22.1% për ecjen dhe 14% për dëgjimin. Shqipëria renditej e dyta në këto kategori.

Përfshirja është komunikimi. Me 7.3% të personave që raportojnë vështirësi të moderuara ose të rënda, Shqipëria kishte nivelin më të lartë në rajon, përpara

Maqedonisë së Veriut me 6.2%, Serbisë me 3.6%, Bosnjë-Hercegovinës me 3.4% dhe Malit të Zi me 2.1%.

Edhe për kujdesin ndaj vetes, Shqipëria kishte një nivel relativisht të lartë prej 8.5%, vetëm pas Maqedonisë së Veriut me 9.2%.

### Një problem rrallë vjen i vetëm

Të dhënat tregojnë edhe se një person mund të raportojë njëkohësisht disa lloje vështirësish. Për Shqipërinë, shumica e gjashtë kategorive arrin në rreth 79%, megjithëse vetëm 28.4% raportojnë të paktën një problem.

Në mënyrë të thjeshtuar, raporti mes këtyre treguesve sugjeron se personat shqiptarë që kanë të paktën një vështirësi raportojnë mesatarisht rreth 2.8 lloje problemesh. Në BE, Eurostat llogariste rreth 2.1 lloje vështirësish për person mes atyre që kishin të paktën një kufizim në vitin 2022.

Në Europë, të ardhurat bëjnë diferencë

Raporti më i fundit i Eurostat për kushtet e jetesës në Europë e lidh fort praninë e këtyre vështirësive edhe me gjendjen ekonomike.

Në vitin 2025, për secilën nga gjashtë aktivitetet, europianët në rrezik varfërie raportojnë më shpesh vështirësi sesa pjesa tjetër e popullsisë. Diferenca ishte më e fortë tek ecja: 24.9% e personave në rrezik varfërie raportojnë probleme të moderuara ose të rënda, kundrejt 16.9% të atyre që nuk ishin në rrezik, një hendek prej 8 pikësh përqindjeje.

Hendeku mes dy grupeve ishte 6 pikë përqindjeje për problemet me kujtesën dhe



**Përgjimet ekskluzive/ "O shpirt", "o zemër". Vlora, një spiune që pasioni e çoi drejt krimit**



Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni



Mesazhet me shefen e SHISH/ Gys Agasi i mbajti shpresat te Edi Rama deri në fund



Zbulohet kush e zëvendëson Vlora Hysenin në krye të SHISH

përqendrimin, 4.9 pikë për shikimin, 4.3 pikë për kujdesin ndaj vetes, 3.5 pikë për komunikimin dhe 1.8 pikë për dëgjimin.

Mosha është një tjetër faktor i rëndësishëm. Në BE, vetëm 3.4% e personave 16-44 vjeç raportonin vështirësi të rënda në aktivitetet bazë në vitin 2022, ndërsa te grupmosha 65 vjeç e lart përqindja arrinte në 22.7%.

Të dhënat bazohen në anketën EU-SILC dhe në metodologjinë e Washington Group on Disability Statistics. Ato matin vështirësitë e vetëraportuara, jo diagnozat mjekësore, dhe përfshijnë personat 16 vjeç e lart që jetojnë në familje private; personat që jetojnë në institucione nuk përfshihen në popullatën e referencës./Monitor

## Të këshilluara



### Ditë e ngarkuar në Kuvend: Protestë jashtë, interpelanca dhe debate brenda

Kuvendi pritet të ketë sot një ditë të ngarkuar si brenda, ashtu edhe jashtë sallës. Teksa deputetët mbledhen në s...



### Familjet me kryefamiljare gra shpenzojnë 20 mijë lekë më pak

Familjet me kryefamiljare gra shpenzojnë mesatarisht rreth 20 mijë lekë më pak në muaj se ato me kryefamiljar burrë, duke nxjerrë...



### Rritja e çmimeve të banesave u frenua në gjysmën e parë të 2026



### Flet gruaja e shqiptarit të vrrarë gjatë grabitjes në Itali: Jam e shkatërruar

"Dëgjojmë dhe lexojmë kaç shumë gjëra, por dua të them se nuk ka njerëz të mirë apo të këqij. Ka n...



### U qëllua me thikë në Tiranë, ndërron jetë në spital 49-vjeçari

Ka ndërruar jetë në spital 49-vjeçari që u qëllua me thikë mbrëmjen e kësaj të mërkure (23/9) në ...



### Kushtetuesja: Qeveria e Kosovës është legjitime, Presidenti të zgjidhet brenda 6 tetorit

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka nxjerrë vendim mbi konstituimin e kuvendit dhe formimin e qeverisë, pasi të njëjtat u kontestuan nga ...



### Plagoset me thikë 49-vjeçari në Tiranë, arrestohet autori



### Behajdin Allaqi: Çfarë dihet për zhdukjen e tij dhe çfarë konstatoi Gjykata Speciale

Behajdin Allaqi, profesor nga Prizreni dhe veprimtar politik, u zhduk në qershor të vitit 1998. Rrethanat e zhdukjes së tij mbeten të ...



### "Jo në emrin tim"/ Mijëra njerëz mbushin sheshin e Prishtinës

Protesta "Jo në emrin tim" po vazhdon sonte për të tetën natë me radhë në Sheshin "Skënderbeu" ...



### BIRN: Akuzat ndaj shesheve të SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

Akuzat e ngritura ndaj Viora Hysenit për nxjerrje të sekretit shtetëror dhe për krahasim të autorit të krimit kanë dëmtuar, sipas ekspertëve të sigurisë, edhe reputacionin e Shërbimit Informativ të Shtetit, i cili kërkon vite pune për t'u rikuperuar.

## Me sytë katër





22:43

## PAMJET VIRALE/ Presidenti i Haitit pi ujë me kanë në mes të OKB-së

Presidenti i Haitit, Edgar Leblanc Fils është bërë një "yll i memeve" në orët e fundit pas një gabimi epik g...



## PAMJET/ Rrëzohet gjatë stërvitjes në Uells avioni ushtarak britanik

21:28



## "E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..." / Aktivistja i zë pritë deputetes së PS

21:17



## PAM IFT/ 6-vjeçaria kineze vë rekord



## PAM IFT/ Nie nanritur hora në biechkëta

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.